

AKT NORMATIV
Nr.4, datë 13.12.2005

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998, “PËR URBANISTIKËN”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të nenit 21 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“KRRT-ja e qarkut ose e bashkisë mbledhet jashtë radhe, edhe në rastet kur këtë e kërkon KRRTRSH-ja, me vendim me rend dite të përcaktuar. Kur kryetari i KRRT-së së qarkut ose bashkisë refuzon zbatimin e vendimit të KRRTRSH-së, atëherë mbledhja e KRRT-së thirret nga prefekti. Prefekti cakton me urdhër anëtarin e KRRT-së që do ta drejtojë mbledhjen. Mbledhja, në këtë rast, zhvillohet në selinë e prefektit. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të KRRT-së.”.

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha